

**Gjykata Themelore Gjilan - Dega në Kamenicë**, përmes gjyqtarit Burim Shala, në qështjen kontestimore të paditësit B.K. nga ..., Komuna e ..., të cilin me autorizim e përfaqëson F.R. nga ..., kundër të paditurës NSH.”....”, me seli në ..., të cilën e përfaqëson me autorizim B.O. nga ..., për shkak të kompenzimit të dëmit, pas mbajtjes së séancës për shqyrtim kryesor më datën 09.01.2015 mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I.Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.K. nga ..., dhe detyrohet e paditura NSH.”....”, me seli në ....., që në emër të dëmit të shkaktuar paditësit më datën 07.07.2008, nga punëtorja e të paditurës në vendin e punës – për shkak të humbjes së telefonit të markës ... Nr. telefonit, t’ia shpërblejë dëmin gjegjësisht t’ia paguaj vlerën për telefonin e humbur shumë prej 799.99 Euro (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e nëntëdhjetë e nëntë cent) si dhe kësaj gjykate në emër të taksës për vendim gjyqësor t’ia paguaj shumën prej 15 Euro, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.**

**II.Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.**

## **A r s y e t i m**

Paditësi B.K. nga ..., më datën 14.07.2008, në këtë gjykatë ka parashtruar padi për shkak të kompenzimit të dëmit kundër të paditurës NSH.”....”, me seli në .....

Në seancën për shqyrtim kryesor të qështjës, i autorizuari i paditësit F.R., ka mbetur në tërësi pranë padisë, duke propozuar gjykatës që të administrohen të gjitha provat që janë bashkuar padisë dhe që janë të propozuar në te.

I autorizuari i të paditurës B.O., e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia më pastaj ka theksuar, se është e vërtetë se SH.SH., që është shpallur fajtores me vendim gjyqësor, ka qenë punëtores e të paditurës, mirëpo ajo nuk ka pasur të drejtë të marrë në ruajtje sendet e klientëve përkatësisht qëtetarëve të cilët kanë shkaur për tu freskuar në pishinë, nuk ka ekzistuar një rregull që të punësuarit e të paditurës të marrin sende në ruajtje përfshirë edhe telefonat, prandaj duke u nisur edhe nga ky fakt punëtores ka vepruar në kundërshtim në punën e sajë, prandaj paditësi ka mundur që kërkesëpadinë e tij ta drejtojë në drejtim të punëtores, poashtu e ka kontestuar edhe lartësinë e kërkesëpadisë, ngase ajo nuk përkon me realitetin se në atë kohë nuk ka pasur në treg përshitje telefona të llojit qfarë pretendon paditësi, poashtu edhe nëse ka ekzistuar ky telefon në shitjet në treg nuk ka mundur të

kushtoj 799.99 Euro, ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta refuzojë si të pa bazuar, e poashtu i ka propozuar gjykatës që për seancën e ardhshme do ti sjellë provat nga kompanit që merren me prodhimin dhe shitblerjen e telefonave mobil, se një telefon i tillë në atë kohë nuk ka qenë në përdorim.

Gjykata pas ndëgjimit të palëve gjegjësisht të përfaqësuesve të autorizuar të tyre, ka administruar provat e propozuara nga ta si ka ndëgjuar dëshmitarin I.T., ka lexuar deklaratën e paditësit B.K., dhënë në polici më datë 07.07.2008, me numër të rastit 2008-CB-0300, deklaratën e dëshmitares F.J.,VR. Nr..., faturën e telefonit, nr..., deklaratën e Sh.Sh. me numër të rastit 2008-CB-0300, aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate P.nr.215/08, pas administrimit të këtyre provave një nga një dhe të tërave bashkarisht në kuptim të nenit 8 të LPK-së, pas analizimit të tyre me kujdes dhe qmuarjes së lirë gjykata ka vërtetuar faktin gjendjen faktike, prej së cilës gjendje faktike ka rezultuar se kërkesëpadia është e bazuar.

Në këtë qështje juridike mes palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësit i kishte humbur një telefon në recepcionin – hyrjen e pishinës ,... (në vendi ku bëhet pagesa e biletave), poashtu nuk ka qenë kontestues as fakti se punëtorja e të paditurës me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është shpallur fajtores për veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 269 parag. 1 i KPK-së.

Mes palëve kontestues ka qenë fakti se a i bie përgjegjësia të paditurës për një veprim që e ka bërë punëtorja e sajë gjatë orarit të punës tek e paditura, pra a ka pasur të drejtë punëtorja t'ia ndalë telefonin për ruajtje paditësit në kohën kur ky kishte paguar biletën dhe kishte hyrë në pishinë për tu freskuar, poashtu kontestues ka qenë edhe lartësia e kërkesëpadisë e sidomos fakti se një telefon i tillë i avancuar në atë kohë nuk ka qenë në shitje, por edhe nëse ka qenë në shitje nuk ka qenë me një çmim kaq të lartë.

Gjykata duke marrë për bazë faktet jokontestuese mes palëve e ka marrë si të vërtetuar faktin se paditësi më datën 07.07.2008, rreth orës 16:30 minuta në recepcionin e pishinës ... në ....., ai ka lënë në ruajtje – besim punëtorës së të paditurës Sh.Sh. – recepcioniste një telefon mobil, pra këtë fakt gjykata e ka marrë si të vërtetuar, poashtu si të vërtetuar edhe faktin se paditësit i kishte humbur një telefon mobil, në recepcionin e të paditurës të cilin telefon, ai kur kishte hyrë në pishinë i'a kishte lënë për ruajtje punëtorës së të paditurës, pra këtë fakt nuk e ka kontestuar as përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës.

Gjykata në këtë qështje juridike është orjentuar në drejtim të vërtetimit të fakteve kontestuese si: sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë e poashtu edhe lartësisë së sajë, pra gjykata së pari me prova e ka vërtetuar se paditësit i është shkaktuar një dëm material, e poashtu e ka vërtetuar edhe lartësinë e dëmit.

Paditësi më datën 07.07.2008, aty rreth orës 16:30 minuta, kishte shkuar në pishinë “...”, për tu freskuar dhe në hyrje të pishinës, kur kishte bërë pagesën e biletës për hyrje në pishinë, punëtorës së recepcionit të të paditurës i’a kishte dorëzuar edhe një telefon të markës ... Nr. i telefonit, e kur ky kishte shkuar për ta kërkuar telefonin kur kishte dalur prej pishinës, punëtorja e të paditurës i kishte thenë, se ia kishte kthyer një personi tjetër në vend që t’ia kthejë paditësit, këtë gjykata e vërtetojë nga deklaratat e vet paditësit dhënë në polici, deklaratat e punëtores së të paditurës Sh. Sh., si dhe nga aktgjykimi i plotfuqishëm i kësaj gjykate P.nr.215/08, prej dt.10.02.2011, si dhe nga deklaratat e dëshmitarit I.T.

Dëshmitari I.T., në seancën për shqyrtim kryesor ka deklaruar se në verën e vitit 2008, së bashku me vëllezërit dhe djalin e tezes B., kemi shkuar për tu freskuar në pishinë “...” në..., kur jemi ofruar te pishinë në recepcion kemi bërë pagesën për hyrje në pishinë dhe punëtorja e pishinës që ka qenë në recepcion, ka thenë se nëse keni diqka të vlefshme mi dorëzoni mua për ruajtje, pasi që në pishinë mund të ndodhë t’ua marrë ndokush sendet dhe të ikë, duke kërcyer telin – rrethojën e pishinës, unë e kam lënë një telefon emir telefonit, ndërkaq djali i tezes B., një telefon të tipit të ri, të cilin i’a kishte sjellur gruaja e tij nga Gjermania, telefoni i tij ka qenë shumë i ri dhe i avancuar, me ti dorëzuar sendet – telefonat kemi bërë pagesën dhe kemi hyrë në pishinë për tu freskuar, kur kemi dalur nga pishina, jemi ofruar në recepcion për ti marrë sendet që i kishim lënë, unë e kam marrë telefonin tim emir telefonit ndërkaq punëtorja e recepcionit B. nuk i’a ka kthyer telefonin, duke i thënë se i’a paskam kthyer tjetër kujtë telefonin, B. e ka lajmëruar policin, telefoni i B. ka qenë i avancuar, unë në atë kohë askujt si kam parë telefon më të avancuar se telefoni i B., ka qenë 8 mega pixel që për vitin 2008, ka qenë shumë i avancuar dhe ka pasur cilësi të lartë të kamerës, ai ka mundur të jetë Nokia apo Samsung, ndërkaq se i’a ka sjellë gruaja e tij telefonin nga Gjermania, unë kam marrëvesh prej familjes së B., ngase ate e kam djalë të tezes, unë nuk jam ekspert i telefonave, por ai telefon atëher ka mundur të kushtoj mes 700 apo 800 Euro i ri.

Nga aktgjykimi i plotfuqishëm i gjykatës P.nr.215/08, gjykata e ka vërtetuar faktin se paditësit i është keqpërdorur besimi dhe telefoni i ka humbur në pishinë NSH.”...”.

Poashtu, ky fakt vërtetohet edhe nga deklaratat e paditësit dhënë në polici, se atij i ka humbur telefoni i markës Nokia NR.... tek e paditura dhe ate në recepcionin e të paditurës.

Prandaj, gjykata sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë ajo me provat e lartë cekura e ka vërtetuar faktin se me pamëdyshje paditësit i ka humbur telefoni mobil i markës Noki NR....tek e paditura dhe ate si rezultat i pakujdesisë së punëtorës së të paditurës, prandaj edhe nga këtu vie detyrimi i të paditurës për kompenzimin e dëmit material paditësit.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë dhe vërtetimit të fakitit se qfarë telefoni e paditura i’a ka humbur paditësit nga mosruajtja e tij, si dhe sa kushton ky telefon në treg, gjykata edhe

këtë fakt e ka vërtetuar me prova, si nga deklarata e F.J., VR.nr....., si dhe fatura e telefonit mobil Nokia Nr... Black, dhe ate fatura nr....., prej dt.11.02.2008.

Dëshmitarja F.J., ka dhënë një deklaratë dhe e ka vërtetuar tek gjykata, dhe ka deklaruar se ajo është shtetase ..., dhe jeton në bashkësi jashtëmartesore me paditësin, më datë 11.06.2008, ka ardhur ti kalojë pushimet verore tek paditësi B., dhe përveq gjërave tjera që i ka sjellur atij - paditësit, i'a kam sjellur edhe një telefon të markës Nokia Nr....Black, të cilin ajo e ka blerë 799.99 Euro dhe i njëjti telefon i ka humbur B. në pishinën NSH.”....”.

Poashtu, edhe nga fatura nr....., prej dt.11.02.2008, vërtetohet se F.J., e ka blerë një telefon mobil ... në filjalin 181-Monchengladbah 2, dhe ate marka e telefonit është Nokia Nr... Black, me imei : ..., i cili telefon ka kushtuar 799.99 Euro.

Pra, gjykata e ka vërtetuar edhe se lartësia e çmimit të telefonit është 799.99 Euro.

Me Ligjin mbi marrëdhënjet e detyrimeve përkatësisht dispozitat e nenit 154 shprehimisht parashihen se kush tjetrit i shkakton dëm ka përgjegjësi t'ia kompenzojë ate, dhe neni 155 shprehimisht e parashihet se qka nënkupton dëmi e që është pakësim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm), që ka ekzistuar në rastin konkret.

Dispozitat e neneve 170 parag. 1 dhe 2 dhe dispozita e nenit 171 të LMD-së shprehimisht parashohin se për dëmin të cilin e shkakton punëtori në punë ose lidhur me punën personit të tretë përgjigjet organizata ku punon punëtori, përveq nëse punëtori ka vepruar ashtu siq është dashur dhe parag. 2 ka të bëjë me faktin kur dëmin punëtori e shkakton me dashje atëherë i dëmtuari mund të kërkojë kompensimin drejtëpërdrejt nga punëtori, poashtu edhe dispozita e nenit 185 parag. 1 dhe 2 të LMD-së, shprehimisht e parashihet se personi që e ka shkakton dëmin duhet ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi e nëse rivendosja nuk është e mundur atëherë dëmi duhet të kompenzohet në të holla e meqenëse në rastin konkret nuk ka mundur të kthehet telefoni fizikisht tek paditësi, atëherë e paditura duhet t'ia kompenzojë dëmin në të holla në vlerën e tregut – vlerën e blerë të telefonit.

Gjykata i ka marrë parasysh pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës se punëtorja nuk ka pasur të drejtë ti ndalë sendet në recepcion, por për gjykatën kjo nuk ishte shumë relevante, faktin se a ka pasur apo jo të drejtë ta ndalë telefonin, (telefonat mobil dhe sendet kanë qenë praktikë që ato të ndalen për ruajtje në recepcion), por sipas dispozites së nenit 170 dhe 171 të LMD-së përgjegjësia për shperblimin e dëmit i bie të paditurës, ngase dëmin e ka shkakton punëtorja e sajë dhe këtë nuk e ka bërë me dashje, e a ka pasur të drejtë apo jo ti ndalë telefonin në recepcion, kjo nuk është bazë që e largon përgjegjësin e të paditurës për kompensimin e dëmit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta në kuptim të nenit 463 të LPK-së, ngase palët në mënyrë të specifikuar nuk i kanë treguar shpenzimet për të cilat kërkojnë shpërblimin, dhe nuk kanë ofruar prova për shpenzimet e bëra.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË**  
**Më datën 09.01.2015**

**Gj y q t a r i,**  
Burim Shala, d.v.

**Këshilla Juridike** - Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.